REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr.249 Prot

Maliq, më 20.04.2026

PROJEKT -VENDIM
Nr. 8 datë 20/04 2026

"Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit"

Bazuar në shkresën me nr.429/6 prot ,datë 15.04.2026 "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile " , mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh) , Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" , i kërkoj Këshillit të Bashkisë :

1. Të miratojë përdorimin e fondit në programin "Emergjencat Civile" në shumën 13,696,340 lekë si më poshtë :

   Tabela për shpenzimet e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Shuma në lekë
1	Rehabilitim nga përmbytjet të infrastrukturës së dëmtuar" Kodi 21AD502 (231)	6,848,170
2	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme – Kodi 91707AB (604)	6,848,170
	Shuma	**13,696,340**

2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Sektori i Emergjencave Civile në bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BASHKISE

GEZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

2419

Maliq, më 20.04.2026

RELACION

" Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit"

Fondi i Emergjencave Civile që jua kemi paraqitur për detajim propozohet nga ana jonë për zbatimin në 2(dy) zëra si më poshtë.

1. Rehabilitim nga përmbytjet të infrastrukturës së dëmtuar" Kodi 21AD502
   -Nga evidentimi i situatës ne territor janë konstatuar disa zona problematike të cilat janë në rrezik të madh për jetën e banorëve dhe kërkohet një ndërhyrje e shpejtë për ti rikthyer në gjendjen e mëparshme por dhe rritja e rezistencës ndaj përmbytjeve të ardhshme.Fondi do të përdoret për rehabilitimin e rrëshqitjes në fshatin Kakac ,Njësia administrative Pirg dhe në urën e Osojës për kalim me tombino.

2. Shpenzime për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi të tjera natyrore e përcaktuar në zërin "Shtetas të ndihmuar ,banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"-Kodi 91707AB

Konceptoi:

Almira Muka

Genci Floqi

KRYETARI I BASHKISE

GEZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ